



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE SJ & I P-A

Nr. 1765 Prot.

Tiranë, më 13/12/2024

Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik

Tiranë

Lënda: Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

Rektorati i Universitetit të Arteve, shpall konkursin për Specialist për parandalimin, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi në UART I (një) vend të lirë pune sa më poshtë:

REKTORATI

DREJTORIA MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE SIJP-A - Sektori i Sallave & Sh.T

- **Specialist për parandalimin, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi në UART.**

Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo kandidat, për pozicionin e punës: Specialist për parandalimin, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi në UART, në dosjen e tij duhet të ketë:

1. Të ketë kryer studimet në arsimin e lartë preferohen studimet në Akademinë e Sigurisë. Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar në MAS;
2. Kandidati duhet të ketë eksperiencë pune të vërtetuar jo më pak se 5 (pesë) vite në sektorin e parandalimit, mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi;
3. Kandidati duhet përfunduar trajnime për parandalimin, mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, të njohura nga institucionet kompetente;
4. Kandidati duhet të vërtetojë nëpërmjet certifikatave të trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, të vlefshme në fushën e parandalimit, mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi;
5. Të njohë programet bazë kompjuterike për menaxhimin e sigurisë dhe dokumentacionit;
6. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese;
7. Të ketë disponibilitet për të punuar jashtë orarit, veçanërisht gjatë aktiviteteve të rëndësishme në sallën e koncerteve;
8. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

9. Të ketë dëshmi të një prej 5 gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht);
10. Të ketë vlerësime pozitive pune nga punëdhënësi i fundit;
11. Të mos ketë marrë ndonjë masë disiplinore për largim nga detyra;
12. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata;
13. Dëshmi e gjendjes mjekësore.

Dokumentacioni që duhet të përmbajë dosja e kandidatit:

1. Kërkesë nga kandidati ku të jetë përcaktuar specialiteti për të cilin konkurron;
2. Diplomë + listë notash fotokopje e noterizuar që vërteton kryerjen e arsimit të lartë (për kandidatët që kanë mbaruar jashtë vendit njehsimi nga MAS);
3. Jetëshkrimi (CV), i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
4. Dokument (fotokopje e librezës së punës), që vërteton përvojën në punë;
5. Letër reference/vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit;
6. Dëshmi e gjuhës së huaj;
7. Kopje e kartës së identitetit;
8. Çertifikatë familjare;
9. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
10. Dëshmi e gjendjes mjekësore.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Universitetin e Arteve nga data 23/12/2024 deri më datë 31/12/2024 ora **14.00**.

Për datën e Konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore çdo ditë nga ora **08.00** deri **14.00**.

Prof. Dr. Erald BAKALLI



REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE